

REVISTA VJETORE

SINDIKATA E
PUNONJËSVE TË
POSTE-TELEKOMIT
SHQIPTAR



2016-2017



Kush jemi?

SPPTSH është një organizatë sindikaliste e punonjësve të Albtelecom, Makhes dhe Postës Shqiptare, e cila është themeluar në shkurt të vitit 1991. Që nga themelimi i saj, kjo sindikatë ka pasur si qëllim të bashkojë dhe të organizojë punonjësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, etnia, raca, profesioni, gjinia apo bindjet fetare.

Themelimi i Sindikatës së bashkuar të PTT në të gjithë Shqipërinë u vendos në shkurt të vitit 1991, ku dy Sindikata ajo e Uzinës PTT dhe PTT Tirana mbajtën Kongresin e Parë. Nga ky kongres u zgjodhën edhe drejtuesit e parë të SPPTSH-së dhe kryetare u zgjodh znj. Rajmonda Paçuka, zv/kryetar. z. Shpëtim Vojsa dhe sekretar z. Aleksandër Miraj. Në vazhdim Sindikata është drejtuar nga të zgjedhurit në Kongreset, që ajo ka organizuar.

Më poshtë po listojmë kongreset dhe kryetarët e zgjedhur ndër vite:

Kongresi II 1995 – znj. Rajmonda Paçuka

Kongresi III 2001 – z. Aleksandër Miraj

Kongresi IV 2005 – z. Shpëtim Vojsa

Kongresi V 2009 – z. Shpëtim Vojsa

Kongresi VI 2014 – z. Renato Muçaj

SPPTSH është një organizatë e ngritur nga aderimi mbi baza vullnetare të punonjësve, dhe ka si mision të mbrojë dhe promovojë interesat e anëtarëve të saj, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar të punës dhe të drejtat e njeriut. Sot, SPPTSH rregullon marrëdhëniet midis punëdhënësit dhe punonjësve të punësuar në Albtelecom, Makhes dhe Postën Shqiptare.

SPPTSH është e organizuar në të gjithë Shqipërinë me disa qendra rajonale. SPPTSH është një nga Sindikatat themeluese dhe anëtare e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë. Gjithashtu, SPPTSH është anëtare në Federatën Ndërkombëtare të Sindikatave, UNI GLOBAL, e cila është ndër më të mëdhatë dhe përfaqëson 20 milion punonjës, nga 900 sindikata në 140 vende të ndryshme.



KRYETARI I SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POSTE-TELEKOMIT SHQIPTAR

Vëllezër e motra sindikalistë të SPTTSH-së,

Të nderuar kolegë,

Jam shumë i lumtur që në prag të kongresit të VII-të do të kemi realizuar botimin e numrit të ri të Revistës Vjetore të Sindikatës sonë. Është e udhës që në këtë revistë t'ju drejtohem me një përshëndetje që do të hapë ket revistë ku me zemër buron një falenderim për të gjithë anëtarësinë e sindikatës sonë, për ata kolegë, që kanë kontribuar gjatë këtyre viteve, gjithashtu, edhe për të gjithë ata aktivistë, që na kanë mbështetur në veprimtarinë tonë sindikaliste, por edhe moralisht për punën fisnike, që kemi bërë deri tani dhe përballjen me sfidat që kemi kaluar edhe ato që na presin. Një falenderim i veçantë dhe vlerësim u takon të gjithë forumeve dhe strukturave të SPPTSH-së, që kanë punuar me seriozitet për të përfaqësuar denjësisht të gjithë punonjësit e seksioneve dhe rajoneve të tyre.



Miq, jam edhe më i lumtur që sot ndaj edhe njëherë me të gjithë ju lajmin e gëzuar për përmbushjen e njëres nga detyrat kryesore të Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit, që është nënshkrimi i kontratave kolektive 3 vjeçare me Albtelecom dhe Makhes. Me firmosjen e kontratave kolektive është përmbushur edhe detyrimi që sindikata ka ndaj të gjithë anëtarëve të saj. Kjo kontratë u garanton të gjithë punonjësve një mbrojtje më të madhe të të drejtave të tyre në punë, kushte më të mira pune, ruajtjen dhe respektimin e të gjithë të drejtave, që rrjedhin nga Kodi i Punës. Gjithashtu, ju garanton të gjitha përfitimet financiare të fituara gjatë këtyre viteve nga Sindikata. Kjo të nderuar miq përcakton misionin sublim të sindikatës për të cilin ne jemi krenarë që luftuam dhe realizuam mbrojtjen nëpërmjet aktit ligjor siç është **Kontrata Kolektive** e punës.

Viti 2016 nuk ka qenë një vit i lehtë. Në muajin shtator 2016, Sindikata është përballur me kërkesën për fillimin e procedurës për Ristrukturimin e Kompanisë Albtelecom. Për qëllim rritjen e efektivitetit të proceseve të punës, reduktimin e kostove dhe optimizimin e strukturës organizative, Albtelecom ka kërkuar largimin e 100 punonjësve nga puna. Në takimin e parë midis palëve, Albtelecom mbështeti idenë se ristrukturimi është i nevojshëm edhe do të ndihmojë kompaninë të ulë kostot e saj operacionale dhe do të rrisë efektivitetin e saj, kurse Sindikata ka argumentuar mospajtimin për largimin e një numri kaq të madh punonjësish, sepse procese të tilla, të përsëritura mbjellin pasiguri në vendet e punës, demotivojnë punonjësit, shkaktojnë pasoja te personat e prekur dhe bëhen shkaktarë të prishjes së proceseve të punës, të cilat në vend që ta shëndoshin mund ta dëmtojnë rëndë kompaninë. Sindikata gjatë negociatave i është drejtuar kompanisë duke i kërkuar rishikimin e studimit në lidhje me largimin e 100 punonjësve nga puna dhe duke qenë se reduktimi i fuqisë punonjëse është një masë e pashmangshme në rrugën e ristrukturimit të kompanisë, ka kërkuar sa më poshtë:

- Uljen e numrit të parashikuar për ristrukturimin e kompanisë në "jo më shumë se 50 punonjës".
- Largimi i punonjësve duhet të përcaktohet qartë në bazë të kriterëve të mëposhtme :
 - o Pozicioni i punës, sipas strukturës së re organizative.
 - o Karriera, eksperiencë, edukimi dhe përshtatja me pozicionin e punës
 - o Performanca e punonjësit për rastet e uljes së punonjësve në pozicione të caktuara
- Të gjithë punonjësit që do të largohen në reformë, duhet të përfitojnë shpërblimin në përputhje me Kodin e Punës.
- Përfshirjen nga reforma të personave, që vuajnë ose kanë vuajtur nga sëmundje të rënda, apo kanë statusin e invalidit.
- ALBtelecom duhet t'u japë përparësi në rimarrjen në punë punëmarrësve të pushuar nga puna .

Pavarësisht presionit të vazhdueshëm gjatë këtyre negociatave të gjata dhe të vështira sindikata jonë ka këmbëngulur në përgjysmimin e këtij numri duke bërë të pamundurën për të mbrojtur sa më shumë vende pune. Në përfundim të këtyre negociatave të gjata me përfaqësuesit e kompanisë edhe në kuadër të fazës së negocimit të kushteve të marrëveshjes për ristrukturim, në bazë të nenit 148 të Kodit të Punës është arritur marrëveshja, ku u përcaktua se numri i personave të përfshirë në këtë proces nuk do të jetë më shumë se 50 punonjës. Gjithashtu, sindikata ka arritur të përfshijë në këtë aktmarrëveshje edhe kërkesat e tjera të saj.

Por gjithsesi viti 2016 ka qenë një vit i suksesshëm edhe për punonjësit e Makhes. Me ndërhyrjen dhe presionin e ushtruar nga sindikata për respektimin e Kodit të Punës dhe kontratës kolektive është arritur të ndryshohet kontrata e shërbimit midis Albtelecom dhe Makhes, ku nuk ishin parashikuar ditët e festave dhe punonjësit penalizoheshin duke dalë në punë edhe gjatë këtyre ditëve. Me ndryshimin e kontratës, janë mundësuar ditët e pushimit gjatë festave dhe është arritur kështu plotësimi i kërkesës së punonjësve të Makhes nga sindikata. Një tjetër lajm i mirë për punonjësit e Kompanisë Makhes ka qenë dhe vendosja e bazës minimale të shpërblimit të vitit të ri në Kontratën Kolektive.

Një numër i madh aktiviteteve sindikale janë zhvilluar, gjithashtu, gjatë vitit 2016, ku ia vlen të theksohen një seri seminaresh në bashkëpunim me fondacionin Gjerman FES mbi dialogun social dhe forcimin e sindikatës, të cilat janë zhvilluar në qytetet Tiranë, Korçë dhe Shkodër. Në këto seminare përveç strukturave të SPPTSH-së kanë marrë pjesë edhe anëtarë nga baza sindikale, të cilët janë trajnuar dhe kanë pasur mundësi në fund të këtyre seminareve të diskutojnë me drejtuesit e sindikatës mbi problematikat në vëndin e tyre të punës. Seminare të tjera trajnuese janë zhvilluar me Solidarity Center dhe UNIGlobal në kuadër të planifikimit strategjik dhe zgjerimit të sindikatës në nivel sektorial. Por një rëndësi i është kushtuar edhe këtë vit aktiviteteve social- kulturore për të vitalizuar anëtarësinë e SPPTSH-së. Në vazhdim të planit të miratuar nga Këshilli Kombëtar janë zhvilluar aktivitete për Seksionin 2, 3 & 6 (Sales, Customer Care, IT) dhe kryesisht në Korçë, Dardhë dhe Dubrovnik. Sigurisht një vend të veçantë këtë vit ka zënë edhe ceremonia e 25 vjetorit të sindikatës, ku kanë qenë të ftuar të gjithë anëtarët e SPPTSH-së. Edhe këtë vit përseri për të gjithë besimtarët myslimanë është shtruar darka e iftarit gjatë muajit të Ramazanit.

Në prag të Kongresit të VII-të që përkon edhe me 26 vjetorin themelimit të Sindikatës sonë, dua të theksoj edhe njëherë se puna jonë për të rritur, forcuar dhe shëndoshur këtë sindikatë në shërbim të të gjithë anëtarëve do të vazhdojë. Ne nuk do të ndalemi deri sa të arrijmë që të kemi një sindikatë, e cila do të jetë një shembull i një sindikalizmi modern në Shqipëri. Ne do të vazhdojmë të luftojmë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë, prandaj të bashkohemi sa më shumë dhe të solidarizohemi për forcimin e mëtejshëm të sindikatës. Sa më shumë investojmë , aq më shumë kemi investuar për një të ardhme më të sigurt, e cila na shërben të gjithëve së bashku.

Sinqerisht,
Renato MUÇAJ
 Kryetari SPPTSH-së

25 VJETORI I SINDIKATËS SË PUNONJËSVE TË POSTË-TELEKOMIT SHQIPTAR.



Sindikata e Punonjësve Postë-Telekomit shqiptar më 26 Shkurt 2016, në mjediset e Muzeut Kombëtar organizoi me rastin e 25 vjetorit të themelimit të saj, një ceremoni madhështore ku, merrnin pjesë shumë delegacione te huaja, personalitete të larta të vendit, përfaqësues të kompanisë, organizata partnere, punonjës të kompanive të tjera telefonike, ish drejtues të SPPTSH-së, dhe një numër i madh punonjësish dhe ish punonjësish të Albtelecom dhe Makhes.

Të ftuarit kryesorë, që mbajtën edhe fjalën e tyre përshëndetëse në ceremoninë e 25 vjetorit ishte Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike znj. Milena Harito, përfaqësuesi i

qendrës së Solidaritetit të Konfederatës Amerikane AFL-CIO, z. Laurie Clements, përfaqësues të Kompanive Albtelecom dhe Makhes, Presidenti i BSPSH-së z. Gëzim Kalaja, përfaqësuesi i Sindikatës së Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës z. Ajet Ahmeti, presidentja e organizates Women Democracy Network Znj. Blerta Balilaj, Presidenti i Nderit të SPPTsh-së z. Shpëtim Vojka, përfaqësuesi i Fondacionit Gjerman FES, Z. Genci Lamllari, presidentja e Qendrës Shqiptare për Sigurinë e Shëndetin në Punë Znj. Frosina Gjino, ish Drejtues te SPPTSH-së, gjithashtu, edhe partnerë të tjerë nga sindikatat motra brenda dhe jashtë vendit, që përshëndetën ceremoninë me anë të videomesazheve.





Ceremonia u hap me një film të shkurtër historik, ku të gjithë të pranishmit ndoqën me interes zhvillimet kryesore të sindikatës në vite. Më pas fjalën e mori Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike znj. Milena Harito, e cila shprehu falenderimin e saj për sindikatën tonë që ka arritur të përfaqësojë me dinjitet punonjësit në punë duke qenë një shembull në shoqërinë Shqiptare. Gjithashtu, ajo nënvizoi rëndësinë që ky sektor ka në ekonominë e vendit, por dhe në jetën e të gjithë qytetarëve. Për këtë arsye znj. Harito i bëri thirrje sindikatës që të shohë me seriozitet zgjerimin e përfaqësimit në të gjithë sektorin e telekomunikacionit duke u munduar kështu të rrisë standardet e punës në këtë sektor. Ajo shprehu vullnetin për të mbështetur zgjerimin e sindikatës brenda sektorit të Telekomunikacionit duke përfshirë edhe operatorët e tjerë të vendit.





Në emër të kompanisë ALBtelecom, përshëndeti z.Indrit Daci, i cili përcolli mesazhin e drejtuesve të kompanisë, që vlerësojnë në maksimum punonjësit dhe bashkëpunimin e deritanishëm me sindikatën. Punëdhënësi Albtelecom është krenar që në kompani e drejta e punonjësit kërkohet nëpërmjet sindikatës dhe kontratës kolektive duke respektuar kështu Kodin e Punës dhe standardet që të gjithë kompanitë e mëdha duhet të respektojnë.

Ceremoninë e përshëndeti edhe Presidenti i BSPSH-së z. Gezim Kalaja. Në fjalën e tij z. Kalaja uroi Sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekomit dhe vlerësoi bashkëpunimin me këtë sindikatë. Ai nënvizoi faktin se kjo është ndër sindikatat e para të krijuara mbas rënies së sistemit komunist edhe është një nga bashkëthemelueset e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.



Sekretarja e Përgjithshme e Sindikatës znj.Andiola Dhemb, përshëndeti ceremoninë me një fjalë të ngrohtë, ku ndër të tjera foli për marrëdhëniet e mira midis punëdhënësit dhe punëmarrësve, si dhe përpjekjet e sindikatës për të mbajtur një standard të lartë në këto marrëdhënie.



Më pas drejtuesja e ceremonies znj. Irida Shehue ja dha fjalën znj. Blerta Balilaj nga organizata Women Democracy Network, e cila pasi përshëndeti sindikatën për aktivitetin e saj në këto vite, vlerësoi bashkëpunimin dhe ndihmën e dhënë nga organizata Women Democracy Network për trajnimin e lidershipit të SPPTSH-së. Ajo u shpreh se ka pasur kenaqësinë të bashkëpunojë me SPPTSH-në dhe se ky bashkëpunim i frytshëm do të vazhdojë edhe në të ardhmen ndërmjet të dy organizatave.



Të njëjtin vlerësim shprehu edhe Presidentja e Albanian Occupational Safety and Health Center (AOSHC) znj. Forsina Gjino. Ajo u shpreh se ka pasur fatin të bashkëpunojë me këtë sindikatë si fillim në një projekt të përbashkët me federatën ndërkombëtare UNIGlobal Union edhe me pas me qendren AOSHC, ku SPPTSH ka qenë e pranishme në çdo aktivitet të organizuar për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Nga Sindikatëse Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës ceremoninë e 25 vjetorit e përshëndeti z. Ajet Ahmeti. Në fjalën e tij z. Ahmeti vlerësoi marrëdhëniet vëllazërore midis të dyja sindikatave dhe iniciativën e kryetarëve për të firmosur një memorandum bashkëpunimi midis tyre.



Kryetari z. Renato Muçaj, nuk kishte harruar te ftonte ne kete 25 vjetor edhe drejtues te mëparshëm të SPPTSH-së, të cilët përshëndetën ceremoninë.

Z.Shpëtim Vojka në cilësinë edhe të Presidentit të Nderit pasi përshëndeti ceremoninë i uroi sindikatës suksese të mëtejshme në punën e saj. Një risi ishte edhe përshëndetja e një nga ish drejtuesit të SPPTSH-së z. Aleksandër Miraj, i cili me anë të një videomesazhi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shprehu vlerësimet më të larta për sindikatën dhe z. Muçaj për këtë mundësi të krijuar për të përshëndetur në ceremoninë e 25 vjetorit të Sindikatës.



Një tjetër përshëndetje me anë të videomesazhit ishte dërguar edhe nga Federata ndërkombëtare UNIGlobal Union. Drejtuesi i Departamentit të Telekomunikacionit z. Alan Tate, uroi sindikatën për këtë 25 vjetor dhe shprehu vlerësimet më të larta për aktivitetin e saj në këto vite. Ai u shpreh i lumtur që SPPTSH është pjesë e UNIGlobal dhe konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e ndërkombëtarëve për Sindikatën e Punonjësve Postë-Telekom të Shqipërisë.

Një ndër të ftuarit e rëndësishëm në këtë ceremoni ishte dhe Drejtori Rajonal i Qendrës së solidaritetit të Konfederatës Amerikane AFL-CIO z. Laurie Clements. Ai mbajti një fjalim të zjarrtë dhe elektrizues për të gjithë të pranishmit në sallë. Z. Clements vlerësoi shpirtin rinor të kësaj sindikate dhe kërkoi nga drejtuesit ta ruajnë këtë rini edhe energji, që e karakterizon këtë sindikatë. Gjithashtu, ai bëri thirrje që sindikata të luftojë me dinamizëm për të drejtat e punonjësve dhe për zgjidhjen e problematikave të tyre. Në fjalën e tij z. Clements konfirmoi edhe njëherë mbështetjen e Qendrës së Solidaritetit për sindikatën e PPTSH-së që ajo të rritet dhe të bëhet një sindikatë me peshë dhe një shembull në Shqipëri. Në fund të ceremonisë z. Laurie Clements iu dha edhe një certifikatë mirënjohjeje për ndihmën që ka dhënë Qendra e Solidaritetit për SPPTSH-në.





Kryetari i Sindikatës, në fjalën e rastit bëri një analizë të punës së sindikatës gjatë këtyre 25 viteve, si edhe punën që është bërë vitet e fundit për të ndryshuar imazhin e Sindikatës. Gjatë fjalës së tij, Kryetari falenderoi të gjithë pjesëmarrësit edhe partnerët të cilët e kanë ndihmuar SPPTSH-në këto vite. Në fjalimin e tij kryetari ndër të tjera u shpreh:

"Jam shumë i lumtur t'ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen tuaj në ceremoninë e 25 vjetorit të Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekom, por jam akoma më i lumtur që në këtë sallë ndodhen edhe shumë shokë, miq e dashamirës apo familjarë të kolegëve tanë, të cilët ndofta për herë të parë sot, kanë dëgjuar të flitet për sindikatën, për përpjekjet që bëhen për tejkalimin e sfidave apo për sukseset që këto sindikata kanë arritur për punonjësit e tyre. Prandaj ndjehem i kënaqur që shumë nga ata, kur të largohen nga këtu do të kenë më shumë informacion mbi sindikatën dhe jam i sigurt që këto informacione do t'i krahasojnë me kushtet e vendeve të tyre të punës, duke analizuar akoma më mirë nevojën që mund të kenë për të qenë të organizuar në një sindikatë, e cila mund t'i ndihmojë të ndryshojnë thellësisht mjedisin, ku punojnë.



Sot mbushet plot çerek shekulli që nga themelimi i sindikatës sonë në shkurt të vitit 1991. Të gjithë sindikatat e pavarura që më vonë u organizuan në gjirin e BSPSH-së u bënë njësh me popullin për të rrëzuar regjimin, që ishte në grahmat e tij të fundit.

Prandaj dua të falenderoj dhe të vlerësoj punën që kanë bërë të gjithë ata kolegë të cilët kanë drejtuar më përpara Sindikatën e Punonjësve të Postë-Telekom. Janë ata kolegë që 25 vjet më parë e themeluan këtë sindikatë si domosdoshmëri për bashkimin dhe organizimin e të gjithë punonjësve të PTT-së, pavarësisht nga etnia, profesioni, gjinia, bindja politike apo besimi i tyre fetar.

Zgjedhja e një zonje si kryetare e parë e sindikatës, tregon vlerat e larta që kjo sindikatë ka përcjellë që në fillimet e saj duke qenë një shembull i demokracisë së brendshme dhe respektimit të barazisë gjinore. Parime të cilat ne i trashëgojmë edhe sot, ku perfaqësimi i grave dhe vajzave është mbi 35 %. Shumë nga pozicionet kryesore u janë besuar këtyre vajzave dhe grave të sindikatës sonë. Gjatë këtyre



25 viteve sfidat kanë qenë të vështira për drejtuesit e kësaj sindikate si në sektorin publik, ashtu edhe pas privatizimit të Albtelecom. Por pavarësisht, SPPTSH ka arritur të sigurojë mbrojtje për të gjithë punonjësit që përfaqëson, duke siguruar elementin kryesor që është nënshkrimi i kontratave kolektive, si me Albtelecom, me Postën Shqiptare dhe së fundmi me nënkontraktorin Makhes.



Kryetari u ndal edhe tek organizimi i ri i sindikatës, e cili ka dhënë efektet e saj në punën e përditshme:

"Aplikimi i një organizimi të ri perëndimor me "shop Steeard", pra me përfaqësues përgjegjës për çdo seksion filloi të jepte rezultatet e para duke rritur konsiderueshëm numrin e anëtarëve. Kjo strukturë na dha mundësinë të informoheshim direkt për shqetësimet, sygjerimet apo pritshmëritë e punonjësve për sindikatën. Në analizën e vazhdueshme që kemi bërë për të modernizuar sindikatën, këshilli i ri kombëtar i dalë pas kongresit të VI-të në mbledhjet e tij periodike vendosi të ndërmarrë aktivitete të ndryshme për të sensibilizuar punonjësit që të anëtarësohen në sindikatë. Gjithashtu, këto aktivitete u përdorën edhe për të rigjallëruar anëtarësinë aktuale, e cila nuk kishte informacionin e duhur mbi veprimtarinë e sindikatës. Informimi i vazhdueshëm dhe pjesëmarrja e tyre në këto aktivitete ka rikthyer sot ndjeshëm besimin e tyre në sindikatë.

Një element tjetër të cilit i është kushtuar rëndësi ka qenë edhe rritja e kapaciteteve të përfaqësuesve të sindikatës. Në mjedisin e sotëm ne të cilin sindikata jonë operon është shumë e rëndësishme që në tavolinat e diskutimit përfaqësuesit tanë të jenë tepër të përgatitur për të negociuar lidhur me problematikat që mund të përballen. Edukimi i tyre me metoda perëndimore nga partnerët e huaj si UNI Global Union dhe Solidarity Center (AFL-CIO – Sindikata Amerikane) ka rritur ndjeshëm aftësitë e përfaqësuesve të seksioneve për t'u shërbyer më mirë nevojave të punonjësve.



Një pjesë tjetër në fjalën e Kryetarit të sindikates, i ishte dedikuar dhe të ardhmes së sindikatës dhe strategjisë që do të përdorë ajo për përballimin e sfidave që e presin.

"Pasja e një plani strategjik të mirëfilltë na ndihmon për të tejkaluar të gjitha sfidat me të cilat përballlet sindikata sot. Në hartimin e këtij plani strategjik kemi pasur parasysh që të fokusohemi në:

- forcimin e sindikatës duke rritur numrin e anëtarëve
- në krijimin e një klime demokratike në organizatë
- në rritjen e transparencës mbi aktivitetin sindikal
- në rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të sindikatës
- në rritjen e informimit të anëtarëve mbi veprimtarinë.
- në zgjerimin e sindikatës në nivel sektorial.

Me anë të këtij plani strategjik synohet t'i jepet SPPT-së dhe anëtarëve të saj shansi që të jenë një shembull në lëvizjen sindikaliste në Shqipëri. Ne jemi të angazhuar që të plotësojmë çdo pikë të këtij plani për të bërë që kjo lëvizje si brenda edhe jashtë kompanisë, të synojë në rekrutime të reja në sindikatë për të shtuar radhët e saj, ku me qindra punonjës janë ende të paorganizuar dhe të pambrojtur ndaj punëdhënësit. Në këtë rrugë ne nuk jemi vetëm. Janë partnerët tanë kryesorë, që kanë dhënë një ndihmesë të madhe në këto dy vite të fundit, UNI dhe Solidarity, që janë angazhuar për të rritur kapacitetet tona sindikale, dhe në bashkëpunim me ta është hartuar edhe ky plan strategjik, që do ta çojë më shumë përpara punën tonë.



Në mbylljen e fjalës së tij z. Muçaj përcolli mesazhin e mëposhtëm për të gjithë punonjësit:

*"Dua t'ju falenderoj të gjithë ju që ishit sot këtu, veçanërisht të ftuarit, të cilët patën durimin të na dëgjonin deri në fund. Dua të falenderoj të gjithë stafin e sindikatës, që punuan për të arritur këtë event, dhe treguan edhe njëherë si sindikalistë, se vetëm nëse veprojmë të gjithë bashkë mund të bëjmë gjëra të bukura dhe të vërteta. Ashtu siç besoj thellësisht se të gjithë nga kjo sallë do të largohen me një fjalë **"Unë besoj në Sindikatë"**, sepse jo vetëm në historinë e Shqipërisë, por në historinë e të gjithë sindikalizmit në mbarë botën, gjërat që sot i shohim të arritura, i kanë arritur sindikatat, gjëra që sot i marrim të mirëqena si: 40 orë punë në javë, pagesat për orët jashtë orarit, sigurimet shëndetësore, leje e zakonshme e paguar dhe deri në hartimin e Kodit të Punës kanë qenë të gjitha kontribute të luftës së sindikateve në Shqipëri e në të gjithë botën.*



Të gjithë punonjësit duhet të kuptojnë se asnjëherë nuk do të na i japin të drejtat tona në rast se nuk luftojmë të gjithë bashkërisht për to. Çdo punëdhënës pavarësisht marrëdënies së mirë dhe bashkëpunimit që ne kemi me Albtelecom dhe Makhes sot, është i predispozuar të mos lëshojë nga pushteti i tij dhe ta përdorë atë në maksimum për të shfrytëzuar punëmarrësin në çdo moment që i jepet mundësia. Prandaj të gjithë duhet ta kenë të qartë që në këtë përballje duhet të mbështetemi te njëri-tjetri dhe i vetmi mjet për të arritur zgjidhjen e suksesshme të këtyre problemeve është sindikata.

Duke pasur besimin se bashkërisht do të vazhdojmë të kontribuojmë në rritjen dhe forcimin e sindikatës, dua t'i uroj sindikatës sonë në këtë 25 vjetor edhe shumë vite të tjera të suksesshme në shërbim të punonjësve!"

Më pas ceromina e 25 vjetorit të Sindikatës së Punonjësve Postë-Telekom vazhdoj me kokteilin, që ishte shtruar për të gjithë pjesëmarrësit.



TAKIM BASHKËPUNIMI

ME SINDIKATËN "CWU-UK"

Me fteseën e drejtuesit të sindikatës Angleze – Communication Workers Union, z. Dave Ward për të marrë pjesë në Konferencën e CWU dhe për të nisur një bashkëpunim reciprok midis të dy sindikatave, SPPTSH ka marrë pjesë në këtë konferencë duke u përfaqësuar nga Kryetari dhe Zv/kryetari i saj. Gjatë kësaj konference 4 ditore, zhvilluar nga data 25-28 Prill 2016, të gjitha delegacionet pjesëmarrëse u pritën nga z. Dave Ward – Sekretari Përgjithshëm i CWU dhe z. Andy Kerr zv/sekretari i përgjithshëm i CWU për pjesën e Telekomit.



z. Ward shprehu interesin e CWU për të zgjeruar bashkëpunimin dhe rritur mbështetjen ndaj sindikatës sonë. Ai u zotua që nëpërmjet UNIGlobal, ashtu dhe direkt ndërmjet sindikatës CWU, por dhe me ndikimin që kjo Sindikatë ka në Partinë Laburiste në Angli, të japë mbështetje konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të jetës sindikale në Shqipëri. Z. Mucaj e ftoi për zemërsisht z. Ward të vizitojë Shqipërinë për të parë më nga afër fushat konkrete, ku të dy sindikatat mund të bashkëpunojnë. Sekretari i Përgjithshëm i CWU pranoi me kënaqësi ftesën e Kryetarit të SPPTSH-së dhe të dy palët u zotuan që të hartohet një axhendë e mirëfilltë gjithëpërfshirëse për vizitën që CWU do të bëjë në Shqipëri në mënyrë që kjo vizitë të jetë sa më frytdhënëse për të dyja palët.

Z. Ward i informoi delegacionet se ditën e dytë të konferencës ishte rezervuar një takim privat me të ftuarin kryesor, kryetarin e partisë Laburiste z. Jeremy Corbyn. CWU si kontribuese kryesore në themelimin e partisë Laburiste është edhe një nga mbështetëset kryesore të z. Jeremy Corbyn për kryeministër, jo vetëm si kryetar i partisë Laburiste por edhe si një sindikalist i vjetër që është gjithmonë në mbështetje të CWU, por edhe si një njeri me vlera të larta morale për të drejtuar Britaninë e Bashkuar në këto kohë të vështira.

Mbas ditës së parë, ku të ftuarit patën mundësi të ndjekin nga afër diskutimet mbi ndryshimet në rregullat e përgjithshme të sindikatës dhe përcaktimin e një strategjie të re për zhvillimet e reja si në qendër, ashtu edhe në degë të ndryshme të sindikatës. Në ditën e dytë, ashtu siç premtoj edhe z.Ward, CWU përpara mbajtjes së fjalës përshëndetëse kishte organizuar një takim privat me Kryetarin e Partisë Laburiste z. Jeremy Corbyn. Gjatë këtij takimi miqsor që delegacioni i SPPTSH-së zhvilloi me z. Corbyn, binte në sy thjeshtësia e këtij lideri popullor dhe informacioni i shumtë që z. Corbyn kishte edhe për Shqipërinë



Z. Corbyn ndër të tjera ndau mendimet e tij përpara referendumit anglez (BREXIT), që po lobonte për qëndrimin në Bashkimin European, pasi besonte në vlerat e Bashkimit European, megjithëse disa ndryshime ishin të nevojshme për ta, për një Bashkim European më fleksibël për nevojat e të gjithë vendeve anëtare. Pyetjes se z. Mucaj se cili ishte mendimi për Shqipërinë dhe aspirimin e saj në Bashkimin European dhe nëse do të ishte kryeministër a do ta mbështeste aderimin e Shqipërisë në Bashkimin European, z. Corbyn iu përgjigj:

"Faleminderit për pyetjen tuaj, në fundjavën e kaluar kam pasur edhe një takim me Presidentin e Shteteve të Bashkuara z. Obama dhe të dy ndanim të njëjtim mendim se me të gjithë vendet e rajonit tuaj duhet të punohet më shumë me reformat dhe kryesisht me respektimin e të drejtave të njeriut. Ky nuk është një problem vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë vendet e rajonit, që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin European. Vetëm nëse do të shpejtojmë realizimin e këtyre reformave dhe nëse do të rrisim respektimin e të drejtave të njeriut, ku një nga këto të drejta është edhe liria në organizimin në sindikata, vetëm atëherë ne, do të mund t'i afrojmë këto vende më shpejt me Bashkimin European. Sigurisht që unë jam pro zgjerimit të Bashkimit European dhe, nëse Anglia do të qendrojë dhe unë do të jem kryeministër i saj do të mbështes anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Me pas z. Corbyn mbajti një fjalim përpara pjesëmarrësve të konferencës. Fjalim, që u prit me ovacione të mëdha, kur z. Corbyn iu drejtua të gjithëve me fjalët. *"Jam shumë krenar për të gjithë ju, sepse ju jeni gjaku i partisë Laburiste. Ju jeni motivacioni jonë"*

Jeremy Corbyn nxiti konferencën me thirrjen për të luftuar masat shtrënguese dhe për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve: *"Axhenda shtrënguese është" një zgjedhje politike, jo një domosdoshmëri ekonomike*", deklaroi Jeremy, duke shtuar se *"nuk mund të ndalohet rruga juaj për prosperitet, ju duhet të investoni për prosperitet"*

Jeremy bëri thirrje për investime në linja të reja hekurudhore dhe strehim. Ai, gjithashtu, bëri thirrje për një strategji mjedisore bazuar në emisionin zero. Ai foli për rrjetin zyra postare, që është aktualisht nën kërcënim, duke vënë në dukje kontributin që ajo i bën shoqërisë.



Ai i bëri thirrje sindikatës për të punuar nëpër kontinente

për t'u përballur me kapitalin. *"Kjo është fuqia e korporatave globale për të luajtur si macja me miun me të drejtat e punëtorëve. Ne duhet të organizohemi ndërkombëtarisht, tha Jeremy, i cili bëri thirrje për sindikatat të punojnë së bashku me Partinë Laburiste për të kundërshtuar atë që qeveria po bën për njerëzit, që punojnë.*



Jeremy pranoi se qeveria e fundit Laburiste nuk ka bërë mjaft për shfuqizimin e legjislacionit kundër sindikatave. Ai u angazhua jo vetëm për të mbrojtur Shërbimet Universale të Postës, por kërkoi për të zgjeruar efektet mbrojtëse edhe për industrinë e telekomunikacionit. *"Unë kam një ankth të vërtetë në lidhje me rreziqet që paraqet mundësia e një ndarjeje apo copëtimi të Telekomit Angleze (BT)", tha Jeremy.*

Në ditën e tretë të konferencës, ku është diskutuar për politikat e reja të CWU për afrimin e brezit të ri në sindikatë, Kryetari i SPPTSH-së me ftesën e Zv/ sekretarit të Përgjithshëm z. Andy Kerr është ftuar të mbajë një fjalë përshëndetëse në seksionin e konferencës për telekomun, si një shembull për angazhimin e të rinjve në Sindikatë.

Z. Muçaj, pasi ka përshëndetur konferencën e CWU dhe ka vlerësuar mikëpritjen, që i është rezervuar delegacionit Shqiptar, ka ndarë me të gjithë të pranishmit historinë dhe eksperiencën e tij mbas marrjes së detyres si Kryetar i Sindikatës së Punonjësve të Postë-Telekomit të Shqipërisë.

"Kam pasur shumë hezitime përpara marrjes së kësaj detyre, pasi për shkak të moshës së re kam qenë në mëdyshje për të marrë këtë përgjegjësi të madhe, vetëm mbas mbështetjes që më kanë dhënë kolegët që sot i kam pranë edhe në punën e përditshme, kam vendosur për të kandiduar për këtë detyrë fisnike. Me marrjen e kësaj detyre jemi fokusuar te riorganizimi dhe vitalizimi i strukturave. Kemi synuar gjithmonë të sjellim brezin e ri në strukturat e reja të krijuara në mënyrë që ndryshonim rrënjësisht imazhin e sindikatës dhe të fusim një frymë të re në punën e përditshme të saj".



Kryetari i SPPT-së u ndal dhe te vështirësitë, që ka hasur mbas afrimit të brezit të ri -

"Nuk ka qenë e lehtë, ka qenë shumë e vështirë, pasi brezi i ri na hapi sfida të reja. Shumica e tyre kishin nevojë për trajnim, pasi nuk kishin eksperiencën e duhur në trajtimin e problematikave sindikale. Menjëherë kemi nisur trajnime të njëpasnjëshme me partnerët tanë si në Shqipëri po ashtu edhe me ata ndërkombëtarë, duke nisur nga fondacioni gjerman FES, WDN, AOSHC dhe duke vazhduar me mbështetjen e madhe që dha UNIGlobal dhe Solidarity me eksperiencën e tyre. Sot kemi një brez të ri të trajnuar të cilët kanë fituar eksperiencën e duhur për trajtimin e të gjithë problematikave. Sot ne si sindikatë me këtë staf aspirojmë ta çojmë me tej zgjerimin e sindikatës edhe në nivel sektorial duke përfshirë këtu edhe kompani të tjera në fushën e telekomunikacionit"

Kryetari i SPPTSH-së në mbylljen e fjalës së tij nuk ka harruar t'ju flasë të pranishmëve për bukuritë e Shqipërisë dhe i ka ftuar të gjithë ta vizitojnë Shqipërinë si një destinacion turistik i mrekullueshëm që nuk duhet humbur dhe duhet vizituar patjetër. Z.Muçaj e mbylli fjalën me një batutë –

"Kam frikë se një pjesë nga ju do të dashurohen me Shqipërinë dhe nuk do të duan të kthehen më mbrapsht, prandaj shpresoj që miku im Andy Kerr mos të mërzhitet që do të humbi disa anëtarë".

Kjo shkaktoi të qeshura në të gjithë sallën dhe një duartrokitje të gjatë për fjalën e mbajtur nga Kryetari i SPPTSH-së.

SHËNDETI DHE SIGURIA NË PUNË

Një nga detyrimet kryesore që punëdhënësi ka ndaj punëmarrësit është garantimi i sigurisë dhe shëndetit në punë. Siguria në vendin e punës është një nga çështjet kryesore, dhe pa dyshim më e rëndësishmja, jo vetëm për punëmarrësit por punëdhënësin, gjithashtu. Masat që duhen ndërmarrë për të siguruar jetën dhe shëndetin e punonjësve në ambientet e punës janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 10237, datë 18.2.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë në Republikën e Shqipërisë."

Ky ligj përfshin tërësinë e dispozitave, masave teknike, shëndetësore e shoqërore që kanë për qëllim sigurimin e kushteve sa më optimale për të parandaluar aksidentet, sëmundjet profesionale dhe disa sëmundje të tjera të përgjithshme, që lidhen me mjedisin e punës.

Prej shume vitesh kompania ALbtelecom & Eaglemobile garanton jetën dhe shëndetin e punonjësve të saj. Kompania ka përmbyllur detyrimin ligjor për krijimin e Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë. Këshilli përbëhet nga 12 këshilltarë, 6 nga të cilët janë zgjedhur me votë nga punonjësit, dhe 6 të tjerë të caktuar nga punëdhënësi. Te gjithë janë punonjës aktivë të departamenteve të ndryshme.



Ligji parashikon që çdo punëdhënësi, qoftë ai subjekt publik apo privat, vendas apo i huaj, fizik apo juridik, është i detyruar që, nëpërmjet mjekut të punës, të ofrojë shërbimin mjekësor në punë për punonjësit e tij. Për të mbuluar shërbimin mjekësor në punë, kompania Albtelecom ka punësuar një mjeke, e cila u vjen në ndihmë punonjësve në çdo moment të nevojshëm. Krahas angazhimeve dhe aktiviteteve të përditshme të saj, Dr. Flora Mezini u vjen në ndihmë punonjësve të kompanisë sonë duke i informuar ata në mënyrë periodike mbi masat parandaluese, që duhen ndërmarrë gjatë orarit të punës, për të shmangur problemet shëndetësore, që mund të lindin nga qëndrimi ulur për një kohë të gjatë, qëndrimi i tejzgjatur para ekranit të kompjuterit, mungesa e aktivitetit fizik, si dhe këshilla praktike, që ndihmojnë në parandalimin e problemeve me shikimin që shkaktohen pikërisht nga kjo rutinë ditore e punës nëpër ambientet e zyrave. Këto këshilla shërbejnë që punonjësit të jenë të shëndetshëm dhe për të rritur njëkohësisht produktivitetin gjatë orarit të punës.

Albtelecom është, gjithashtu, një shembull, që duhet ndjekur nga të gjitha kompanitë simotra të saj përse i përket sistemit që ka ndërtuar për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj zjarrit, sistem tek i cili janë mbështetur dhe një numër institucionesh të tjera në vend.

Z. Erjon Cela, i specializuar në këtë fushë, përgjegjës për mbarëvajtjen e sigurisë në kompani dhe njëkohësisht këshilltar i sigurisë dhe shëndetit në punë, ka trajnuar punonjësit e kompanisë në lidhje me përdorimin e sistemit të mbrojtjes kundra zjarrit dhe masat parandaluese që duhet të ndërmerren në raste të tilla. Përveç trajnimeve të mundësuar për stafin e kompanisë, z. Cela kryen dhe testime periodike të sistemit të zjarrit në bashkëpunim me të gjitha institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Duhet theksuar se një nga faktorët kryesorë, që garanton mirëqenien e punonjësve të kompanisë Albtelecom & Eagle Mobile është edhe Sindikata e Punonjësve të Postë-telekom, e cila është prej vitesh pjesë aktive dhe e pandarë e kompanisë dhe një kontribuese e fuqishme në përmirësimin e kushteve dhe mbrojtjen e të drejtave të punonjësve të Albtelecom. Kryetari i saj, z. Renato Muçaj, me nismat e ndërmarra nëpërmjet sindikatës ka dhënë një kontribut të vyer për të gjithë punonjësit e Albtelecom.

Punëdhënësit & Punëmarrësit:

Punëdhënësi

Ligji në fuqi është një rregullator i të drejtave dhe detyrimeve të të dy aktorëve kryesorë të tregut të punës, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Është ai, që përcakton se garantimi i sigurisë së jetës dhe shëndetit të punëmarrësve, sigurimi i të gjitha masave mbrojtëse për parandalimin e çdo rrethane që mund të shkaktojë aksidente apo të kërcënojë shëndetin e punonjësve, informimi i herëpashershëm i punonjësve mbi rreziqet e sëmundjeve profesionale, si dhe mundësimi i kontrolleve periodike mjekësore për punëmarrësit janë disa nga detyrimet primare të çdo sipërmarrësi privat apo publik. Punëmarrësi është i detyruar të njoftojë në mënyrë të menjëhershme Inspektoratin e Punës, Institutin e Shëndetit Publik, si dhe organet ligjore në vend për çdo rast aksidenti në punë, apo për çdo problem shëndetësor, që ka lidhje të drejtpërdrejtë me procese të caktuara të një pune të caktuar. Ligji përcakton si aksidente në punë të gjitha aksidentet, që mund të ndodhin gjatë orarit të punës, kohës së pushimit brenda ambienteve të punës, si dhe gjatë rrugës për në punë.

Punëmarrësi

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë parashikon detyrime jo vetëm për punëdhënësin, por edhe për punëmarrësin në të njëjtën kohë. Kështu, punëmarrësi ka për detyrë të përdorë me korrektësi aparaturat, mjetet mbrojtëse, substancat e rrezikshme, pajisjet e transportit dhe mjetet e tjera, si edhe të përdorë me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale të vendosura në dispozicion të tyre, dhe, pas përdorimit t'i rikthejë ato në vendin e caktuar.

Në bazë të këtij ligji, punëmarrësi duhet të njoftojë në mënyrë të menjëhershme punëdhënësin, personin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, si dhe perfaqësuesit e punëmarrësve, për çdo situatë pune, e cila për një motiv të arsyeshëm paraqet rrezikshmëri të menjëhershme për sigurinë dhe shëndetin e punonjësve, si dhe për çdo defekt të konstatuar në sistemin e mbrojtjes.

Kostoja e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfitimit prej tij:

Aktualisht në vendin tonë ekzistenca e një Këshilli Sigurie dhe Shëndetsie, që garanton jetën, shëndetin dhe komoditetin e individit në vendin e punës mund të tingëllojë si diçka e pazakontë, madje, shumë prej kompanive në vend kjo mund t'u duket një çështje krejt e parëndësishme në mesin e një morie problemesh me të cilat ato hasen në tregun e punës. Një nga arsyt është edhe mungesa e informacionit të plotë mbi legjislacionin në fuqi, por arsyeja kryesore është padysim mosvlerësimi dhe neglizhenca ndaj fuqisë punëtore nga punëdhënësi shqiptar. Lidhur me këtë çështje, Inspektorati i Punës dhe Ministria e Punës, Mirëqenies Sociale dhe Rinisë kanë bërë përpjekje të konsiderueshme, duke bërë të mundur që shumë prej sipërmarrjeve në vend të kenë një Këshill Sigurie në përbërjen e tyre. Nëse do të bënim një bilanc të koston dhe përfitimeve që sjell ky lloj organizimi, mjafton të kuptojmë që komoditeti i kushteve të punës rrit ndjeshëm dhe produktivitetin e një punonjësi gjatë orarit të punës. Një punonjës të cilit i mundësohet një mjedis komod dhe i këndshëm pune, jo vetëm që do të përmbushë të gjitha detyrat e caktuara por edhe puna e dorëzuar do të jetë më cilësore, duke i sjellë kështu kompanisë të ardhura më të mëdha. Një mjedis pune jo i rehatshëm, i paorganizuar, i pandriçuar dhe me temperaturë jo optimale ul dëshirën e punonjësve për të punuar, dhe si rrjedhojë zvogëlon dhe të ardhurat e kompanisë. Mungesa e kushteve të punës mund të shkaktojë te punonjësit probleme me shëndetin, problem, të cilat në fund përkthehen në shpenzime për kompaninë.

Albtelecom është kompania e vetme në treg, që zbaton çdo dispozitë ligjore dhe përmbush të gjitha standardet bashkëkohore europiane lidhur me garantimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve në ambientet e punës.

Kryetari Këshillit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.
Armando Jaupi

SUKSESE TË SINDIKATËS GJATË VITIT 2016.

Përpyjekjet e Sindikatës janë të përditshme, por edhe të planifikuara, sipas propozimeve dhe vendimeve të Këshillit Kombëtar. Në bazë të këtyre vendimeve, drejtuesit e Sindikatës bëjnë përpyjekjet maksimale për të mbrojtur të drejtat e punonjësve dhe për të plotësuar kërkesat kolektive që punonjësit kanë në lidhje me kushtet e punës, pagat apo trajtime të tjera, që duhet të kenë për ta bërë punën e tyre sa më të denjë.


Këtë vit kemi mundur të realizojmë:

- Nënshkrimin e kontratës kolektive me Albtelecom për 3 vjet, sipas ndryshimeve të Kodit të Punës
- Nënshkrimin e kontratës kolektive me Makhes për 3 vjet, sipas ndryshimeve të Kodit të Punës.
- Uljen e numrit të të prekurve në reformë në Albtelecom nga 100 punonjës në 50 punonjës.
- Kemi përmbushur kërkesën e teknikëve të Makhes për të ndaluar daljen në punë gjatë ditëve të festave. Sindikata për realizimin e kësaj kërkesë ka ndërhyrë duke ushtruar presionin e saj për ndryshimin e kontratës së shërbimit që të parashikohej pushimi për ditët e festave zyrtare.
- Në kontratën e re kolektive të Makhes është përfshirë dhe shpërblimi i vitit të ri prej 5000 lekë.
- Mbas negociatave të Sindikatës është rritur përsëri shpërblimi i vitit të ri për Albtelecom nga 20,000 lekë që është i parashikuar në kontratën kolektive në 25,000 lekë.



NËNSHKRIMI I KONTRATËS KOLEKTIVE ME MAKHES ALBANIA.

Disa seanca negociatash janë zhvilluar me Makhes për të përfshirë të gjitha ndryshimet e Kodit të Punës në kontratën e re kolektive. Mbas këtyre negociatave është arritur të përfshihet dhe baza minimale prej 5000 lekë e shpërblimit të vitit të ri në kontratën kolektive. Procedura e nënshkrimit të kontratës kolektive është zhvilluar në Kompaninë Makhes Albania ndërmjet Kryetarit të SPPTSH-së dhe Administratorit të Makhes Albania z. Rrezart Muja.



NJË SINDIKATË MË INTELIGJENTE

Një rëndësi të veçantë në luftën sindikale zë pjesa e edukimit si për përfaqësuesit e Sindikatës, ashtu edhe për anëtarët e saj. Ka qenë pikërisht vullneti i Kryetarit z. Muçaj për të rritur sa më shumë numrin e seminarëve edukues për të gjithë përfaqësuesit e sindikatës.

Duke përdorur të gjitha lidhjet me partnerët tanë kemi arritur të rrisim ndjeshëm seminarët edukues mbi format e reja të organizimit të sindikatës. Bashkëpunimi i shkëlqyer me UNI Global Union dhe me Solidarity Center (AFL-CIO – Sindikata Amerikane), por dhe besimi që këto dy institucione prestigjioze kanë krijuar gjatë punës me sindikatën tonë, ka sjellë një numër të konsiderueshëm seminaresh për mënyrat e reja perëndimore të menaxhimit dhe organizimit të sindikatës. Gjithashtu, nga ana tjetër Z. Muçaj ka vënë në dispozicion të gjithë fuqinë e burimeve njerëzore të sindikatës, të cilët janë përkushtuar maksimalisht për të përthithur këto mënyra të reja dhe për t'i vënë ato në zbatim me rigorozitetin e duhur. Pjesëmarrja e lartë gjatë këtyre seminarëve dhe përkushtimi i përfaqësuesve të sindikatës, ka rritur në maksimum efikasitetin e lëvizjes së SPPTSH-së.

Në të njëjtën mënyrë, SPPTSH edhe në rrafshin kombëtar ka rritur bashkëpunimin edhe me institucione të tjera prestigjioze siç është fondacioni gjerman Friedrich-Ebert-Stiftung (FES). Këto bashkëpunime me fondacionin FES kanë sjellë organizimin e një serie seminaresh për drejtuesit dhe anëtarët e SPPTSH-së, duke zhvilluar seminar në rajonet Tiranë, Korçë, Shkodër.

SEMINAR EDUKUES “DIALOGU SOCIAL” FES – SPPTSH, - TIRANË



Në datën 21.10.2016, në bashkëpunimin midis FES dhe SPPTSH u mbajt seminari me temë “Dialogu Social”. Me anë të këtyre seminareve është synuar të trajtohet tema e dialogut social por duke qenë se në këtë seminar kanë qenë të ftuar edhe pjesë e bazës së antarësisë është dhënë edhe një informacion më i detajuar për sindikatën, kontratën kolektive por edhe informacione të tjera të nevojshme për anëtarët.



Lektorja e FES për këtë seminar znj. Hiqmete Daja, bëri jo vetëm një zbërthim të elementeve të dialogut social, por ndau me të pranishmit edhe shumë shembuj nga jeta dhe përvoja e saj e gjatë me sindikatat. Në fund të gjithë pjesëmarrësit punuan në grupe duke trajtuar raste konkrete me të cilat ishte përballuar sindikata jonë.



SEMINAR EDUKUES "DIALOGU SOCIAL" FES – SPPT, - KORÇË

Sindikata e Punonjësve Postë-Telekomit Shqiptar SPPTSH në bashkëpunim me fondacionin gjerman Friedrich Ebert ka zhvilluar në qytetin e Korçës seminarin me teme: Dialogu Social. Në këtë seminar kanë marrë pjesë anëtarë të sindikatës së rajonit Korçë dhe Elbasan, nga kompanitë Albtelecom dhe Makhes. Qëllimi i këtij seminari ka qenë trajnimi i anëtarëve të këtij rajoni për Dialogun Social, një mekanizëm shumë i fuqishëm për të zgjidhur problemet midis punëdhënësit edhe punëmarrësit.

Lektorja e këtij seminari znj. Hiqmete Daja, nuk ka kursyer edhe këtë herë shembuj nga jeta dhe përvoja e saj e gjatë me sindikatat.

Gjithashtu, të gjithë anëtarët janë informuar në fund nga kryetari z. Renato Muçaj për aktivitetin e sindikatës dhe zhvillimet e tjera për të dy kompanitë. Mbledhja me anëtarët e këtij rajoni ka vazhduar me zgjedhjen e përfaqësuesve të rinj të rajonit. Për këtë seminar ka pasur një interesim të madh edhe të mediave lokale, të cilat e kanë pasqyruar të gjithë aktivitetin dhe kanë intervistuar Kryetarin e SPPTSH-së në lidhje me seminarin e zhvilluar në qytetin e Korçës.



SEMINAR EDUKUES “DIALOGU SOCIAL” FES – SPPTSH, - SHKODËR

Në vazhdimësi të bashkëpunimit me fondacionin gjerman FES, SPPTSH ka zhvilluar me 26.11.2016, në Shkodër Seminarin e radhës me temë “Dialogu Social”. Në këtë seminar kanë marrë pjesë anëtarë të sindikatës së rajonit Shkodër-Lezhë dhe rajonit Kukës-Peshkopi.

Të pranishmëve përveç trajnimit mbi dialogun social, lektorja e seminarit znj. Hiqmete Daja u ka shpjeguar edhe për elementet e tjerë sindikalistë siç është kontrata kolektive, negociatat, këshilli kombëtar i punës, etj.

Një numër i madh mediash lokale të qytetit të Shkodrës kanë qenë të interesuara për pasqyrimin e aktivitetit. Mediat, gjithashtu, janë informuar nga kryetari i sindikatës mbi aktivitetin dhe punën e sindikatës në të dyja kompanitë.

Kryetari i sindikatës z. Renato Muçaj, ka theksuar edhe njëherë faktin se vetëm nëse jemi të bashkuar në sindikatë mund të organizohemi më mirë për të mbrojtur të drejtat tona të përbashkëta. Mbledhja me anëtarët e pjesëmarrësit ka vazhduar me zgjedhjen e përfaqësuesve të rinj të rajoneve.



SINDIKATA DHURON BILETA PER FESTIVALIN E 55-të NE RTSH.

Ky dhurim vjen si pjesë e mbylljes së vitit 2016 dhe si vazhdim i vizionit të ri të sindikatës për të sensibilizuar çdo punonjës, për t'u bërë pjesë e saj, sepse nëse duam të kemi një sindikatë sa më të fortë, skepticizmi duhet t'i lërë vendin, përfshirjes, kontributit dhe bashkimit në sindikatë të të gjithë punonjësve. Përveç bashkimit dhe rritjes së kontributit nuk ka rrugë tjetër, sepse sindikalizmi nuk është një betejë, që fitohet njëherë, por mbetet një luftë e vazhdueshme në mbrojtje të interesave tona të përbashkëta. Më poshtë është edhe njoftimi zyrtar i Departamentit të Burimeve Njerëzore të cilët janë treguar të gatshëm për të ndihmuar në shpërndarjen e biletave.



Të dashur punonjës,

Kemi kënaqësinë t'ju informojmë se Sindikata e Punonjësve të Postë-Telekomit Shqiptar ka dhuruar 7 bileta çift për natën e dytë të Festivalit të 55-të të Këngës në Radio Televizion, i cili do të organizohet sot në datën 22 dhjetor, ora 20:00 në Pallatin e Kongreseve. Departamenti i Burimeve Njerëzore organizoi një short nga i cili dolën fitues punonjësit e mëposhtëm:

- Elmira Gaxho
- Sonila Drita
- Bernard Rexha
- Alda Shehu
- Ledion Rista
- Valbona Grevi
- Spartak Mehmeti

Fituesit janë të lutur të tërheqin biletat pranë zyrës së Departamentit të Burimeve Njerëzore.

Faleminderit!
DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

DARKA E IFTARIT NGJA SINDIKATA

Siç është bërë traditë tashmë sindikata edhe këtë vit ka shtruar për të gjithë punonjësit besimtarë Darkën e Iftarit gjatë muajit të Shenjtë të Ramazanit, ku kanë qenë të ftuar të gjithë punonjësit e besimit mysliman. Darka është shtruar në ambientet e Kompleksit Taivan te Restorant "Steak House".

SEMINAR SPPT – UNI – AFL-CIO

Në datë 6-7 shkurt 2016, sindikata ka zhvilluar në Tiranë në bashkëpunim me Uni Global dhe AFLCIO, takimin e përbashkët për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive tona organizative. Në këtë seminar edukues, ku merrnin pjesë përfaqësuesit e sindikatës jemi fokusuar në planifikimin strategjik dhe në detajet e hartimit të këtij plani. Përfaqësuesit e Sindikatës, në drejtimin e z. Laurie Clements (Solidarity Center) dhe z. Javier Carles (UNI) kanë punuar në grupe pune gjatë seminarit, duke praktikuar të gjithë informacionin e marrë gjatë seminarit dy ditor. Ky trajnim ishte një ndihmë e madhe për t'u fokusuar më shumë te Vizioni dhe Misioni që Sindikata duhet të ketë dhe hartimin e një plani për mënyrat që duhet të përdori për të arritur objektivat e saj strategjike.



SEMINAR DHE TAKIM PËR TË ORGANIZUAR **DEUTSCHE TELEKOM** NË SHQIPËRI

SPPT – UNI – VER.DI - AFL-CIO – OME-OTE - FES

SPPTSH, si pjesë aktive e aleancës për Deutsche Telekom, vazhdon të kontribuojë në organizimin e Deutsche Telekom Albania edhe në kuadrin e zgjerimit të sindikatës në nivel sektorial. Një takim produktiv me UNI dhe Qendrën e Solidaritetit është zhvilluar në korrik, ku është hartuar edhe një plan operacional për veprimet që do të ndërmerren. Në vazhdim të planit, operacional për të realizuar një takim edhe me kompaninë Telekom Albania, dhe me suportin e fondacionit gjerman FES është organizuar një takim, ku kanë qenë pjesëmarrëse në mbështetje të SPPTSH-së, sindikata gjermane VER.DI dhe sindikata gjermane OME-OTE, gjithashtu, pjesëmarrëse në këtë takim kanë qenë edhe Qendra e Solidaritetit (AFL-CIO) dhe UNIGlobal, që kanë pasur mundësinë të trajnojnë edhe të pranishmit për sjelljet e mundshme, që mund të vijnë mbas takimit me kompaninë edhe se si duhet vepruar dhe folur me punonjësit.



Në përfundim të seminarit dy ditor, që u zhvillua në datat 17-18 shtator, u vendosën pikat, të cilat do të diskutoheshin në datën 20 shtator 2016 me kompaninë.



TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E TELEKOM ALBANIA

Në datën 20 shtator kemi pasur takimin e parë zyrtar me drejtuesit e kompanisë për organizimin e sindikatës në Telekom - Albania. Në takimin e mbajtur në mjediset e Telekom - Albania në Laprakë, morën pjesë përfaqësues të Telekom - Albania, Znj Biljana Nikolic, Kryetari i Sindikatës së Punonjësve Postë - Telekom z. Renato Muçaj, përfaqësuesi i Sindikatës Gjermane Ver.di, të Deutsche Telekom, përfaqësuesit e Sindikatës Greke OME-OTE, përfaqësuesi i Sindikatave Ndërkombëtare UniGlobal Union.

Delegacioni jonë njoftoi drejtuesit e Telekom – Albania se Sindikata e Punonjësve Postë-Telekom e Shqipërisë, dëshironte të fillonte të kontaktonte të gjithë punonjësit për organizimin e tyre në sindikatë dhe për të arritur nënshkrimin e kontratës kolektive të punës. Përfaqësuesit e Telekom Albania, shprehen mbështetjen e tyre për këtë nismë në mënyrë që punonjësit e Telekom -Albania të kenë mundësinë e organizimit në sindikatë, si e gjithë pjesa tjetër Europiane e Deutsch Telekom Group.

Megjithë pozicionit "neutral" që kompania është munduar të tregojë përsëri SPPTSH është gjendur përpara vështirësive për të ushtruar një komunikim të drejtpërdrejtë me punonjësit e Telekom Albania, të cilët ende vuajnë historikun e kaluar të organizimit të sindikatës. SPPTSH po vazhdon komunikimin me kompaninë në mënyrë që të bindë drejtuesit e saj për të nisur një dialog social midis palëve dhe bashkërisht për të evidentuar nevojat e punonjësve. SPPTSH mendon se koha është tani prandaj me mbështetjen tonë dhe të të gjithë partnerëve ndërkombëtarë jemi në momentin e duhur për të shkruar këtë histori për të gjithë punonjësit e Telekom-Albania.



TAKIMI I DEUTSCHE TELEKOM ALLIANCE

One Telekom Union – Nje Sindikatë e Telekom-it

Deklarata e Aleancës së Deutsche Telekomit

Deutsche Telekom AG (DTAG) është shndërruar në një shoqëri të vërtetë evropiane me shumë nga shërbimet e saj duke u konsoliduar dhe përhapur rreth disa vendeve në Evropë. Ky transformim përfshin integrimin e teknologjive të reja, riformësimin e strukturës organizative, si dhe riorganizimin e çështjeve të personelit në nivel pan-evropiane. DTAG e quan këtë proces One Telekom Europe. Ekziston edhe një mundësi që kompania do të ndryshojë strukturën e saj ligjore në një shoqëri evropiane (Societas europaea) në të ardhmen.

Sindikatat në UNI - Aleancën Deutsche Telekom, duke kuptuar se mbështetja reciproke, bashkëpunimi i ngushtë, ndarja e informacionit, dhe solidariteti në nivel ndërkombëtar janë të nevojshme për mbrojtjen dhe të ardhmen e punëtorëve DTAG në Evropë, e konsiderojnë të nevojshme për të krijuar një formë të re të sindikatës Evropiane për të ndikuar në planet e **Një Telekom Europë** dhe për të mbrojtur interesat e punëtorëve.

Për këtë qëllim, sindikatat në Aleancë, në takimin në Budapest 7-8 qershor 2016 bien dakord për të formuar One Telekom Union (OTU). OTU do të thotë një bashkëpunim të ngushtë në mes të sindikatave kombëtare, këshillat e punëve kombëtare, Këshilli i Punës Evropiane, anëtarët e sindikatës së bordeve mbikëqyrëse të kompanisë, dhe UNI Global Union. OTU do të zëvendësojë Aleancën Deutsche Telekom, dhe do të jetë bazë për bashkëpunim të mëtejshëm bashkim mes sindikatave në DTAG në Evropë. Fokusi kryesor do të jenë çështjet pan-evropiane, që janë të rëndësishme për anëtarët OTU.

Qëllimet e OTU, siç është rënë dakord nga ana e pjesëmarrësve, do të jenë:

- Ndikimi në vendimet rreth One Telekom Europe
- Zhvillimi i strategjive të përbashkëta për të mbrojtur interesat e punonjësve
- Koordinimi i qasjeve të përbashkëta dhe strategjive
- shkëmbimi rregullisht i informacionit
- Koordinim dhe bashkëpunim me UNI Global
- Koordinimi dhe bashkëpunimi me EWC
- Ndikimi në rregullimin Evropian të tregut të telekomunikacioneve

Një komitet drejtues do të ngrihet për të udhëhequr punën e OTU mes takimeve. Komiteti drejtues do të koordinohet nga UNI me Ver.din duke marrë një rol udhëheqës për shkak të afërsisë gjeografike dhe aftësinë e tij për të ndikuar në menaxhimin e DTAG. Grupi drejtues fillimisht do të strukturohet si vijon:

- 4 delegatë nga Evropa Qendrore dhe Lindore
- 1 delegat nga Austria
- 2 delegatë nga VERDI
- 1 delegat nga EWC
- 1 delegat nga UNI

OTU dhe grupi drejtues menjëherë do të fillojnë punën pas miratimit të deklaratës nga të pranishmit. Bordi drejtues i DTAG do të informohet nga Unioni dhe UNI për formimin e OTU dhe objektivat e saj sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundur. Grupi drejtues do të takohet edhe me menaxhimin e DTAG në mënyrë që të fillojë dialogun me kompaninë.

Miratuar nga të gjitha sindikatat e pranishme. Budapest 8 qershor 2016.

TAKIME TE NDRYSHME NGA AKTIVITETI SINDIKAL I SPPTSH-së GJATË VITIT 2016

TAKIME PËR KODIN E PUNËS - BSPSH DHE FES

Në dt 12.02.2016 në zyrat e BSPSH-së , në bashkëpunim me FES u zhvillua seminari me temë " Ndryshimet në Kodin e Punës" , ku morën pjesë të gjitha federatat. Lektori Ledio Milkani zhvilloi debate të ndryshme në lidhje me ndryshimet e fundit në K. Punës, si dhe me Konventat e ILO-s. Prezantime të tjera u mbajtën nga Renato Muçaj, Gani Lami, Hiqmet Mellas , Myftar Ismalaja , Bruno Hoxha, etj.



TAKIM BSPSH – AFL-CIO- SPPT

Përfaqësuesi i ri i AFL-CIO z. Laurie Clements zhvilloi një takim me Presidentin e BSPSH z. Gëzim Kalaja në selinë e BSPSH-së . Në këtë takim ishte zv. Presidenti i SPMSH z. Jonuz Xhetani dhe Presidenti i Sindikatës së Punonjësve të Postë- Telekomit Shqiptar z. Renato Muçaj. Z. Clements zhvilloi trajnimin 2 ditor me sindikalistë të SPPTSH dhe kërkoi bashkëpunim për seminare në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.



SPPTSH NË 25 VJETORIN E BSPSH-së.

SPPTSH e ftuar nga Presidenti i BSPSH-së z. Gëzim Kalaja ka marrë pjesë me 10 delegatë në ceremoninë e 25 vjetorit të themelimit të BSPSH-së. Në këtë aktivitet ishin të ftuar përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor, përfaqësues të opozitës, të sindikatave homologe, përfaqësues të organizatave të punëdhënësve dhe të shoqërisë civile. Konferencën e nderuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të organizatave sindikale nga vende të ndryshme të Europës. Konferenca u hap me dokumentarin e BSPSH-së, i cili tregon historinë e lëvizjes sindikale në vitin 1991, si dhe



përplekjet e BSPSH-së dhe Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë për përmbysjen e regjimit komunist. Për kontributin 25 vjeçar BSPSH dhe SPMSH u dekoruan nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani. Dekorata "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" iu dha BSPSH me motivacionin "Për rolin e veçantë, në lëvizjen punëtore të vendit tonë dhe përmbysjen e diktaturës komuniste, mbrojtjen e stabilitetit, përmirësimin e kushteve sociale, mbrojtjen e interesave, lirive dhe të drejtave të punonjësve, respektimin e bashkëpunimit, dialogut social, si dhe për integrimin e Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare" – Dekreti nr. 9490, dt. 25.03.2016. SPMSH – së iu dha "Dekorata e Artë e Shqiponjës" me motivacion: "Për kontribut të shquar në lëvizjen sindikaliste të vitit 1991, që kulmon me aktin sublim të grevës së urisë së minatorëve, e cila bëri të mundur rrëzimin e diktaturës komuniste dhe hapjen e rrugës për transformime të mëdha demokratike në Shqipëri" – Dekreti nr. 9491dt. 25.03.2016. Gjithashtu, Presidenti i Republikës së Shqipërisë u akordoi Dekoraten "Pishtar i Demokracisë": znj. Pranvera Bodinaku – Presidente e Sindikatës së Tregtisë dhe Turizmit, znj. Hatixhe Boriçi – Kryetare e BSP Lushnje, z. Nevruz Kaptelli – President i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, z. Koço Jani – Sekretar Organizativ i BSPSH, z. Myftar Ismalaja – President i SPILT me motivacion: "Si themelues dhe pjesëmarrës aktiv që nga ngjarjet e vitit 1991, si dhe për kontributin e shquar në lëvizjen punëtore në Shqipëri"

SPPTSH E FTUAR NGA AOSHC PER SIGURINË DHE SHENDETIN NË PUNË.




Në vazhdim të bashkëpunimit me Qendrën Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Sindikata jone ka qenë e ftuar në aktivitetin e organizuar nga përfaqësuesja e qendrës znj. Frosina Gjino. Në këtë panel ku merrnin pjesë Sindikata të ndryshme, përfaqësues të Ministrisë, Inspektoratit të Punës dhe Urdhërit të Mjekut u diskutua mbi legjislacionin e sigurisë dhe shëndetin në punë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e këtij legjislacioni në të gjithë sektorët. Në fund të takimit u vendos që të vazhdohej me grupe të vogla interesi për të diskutuar më në detaje legjislacionin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

AKTIVITETET SOCIAL-KULTURORE PËR ANËTARËT E SEKSIONIT 6- IT GROUP

Sindikata e Punonjësve Post-Telekom, në vazhdim të aktiviteteve Sociale, për të rritur frymën kolektive të punonjësit ka zhvilluar me Grupin e IT-së udhëtimin e radhës në Dubrovnik. Një udhëtim i organizuar në bashkëpunim me të gjithë anëtarët pjesëmarrës, ku sindikata ka financuar një pjesë të paketës së udhëtimit në bazë të buxhetit të përcaktuar për të gjitha grupet, ndërsa pjesa tjetër është financuar nga vetë pjesëmarrësit. Duke falenderuar të gjithë organizatorët Armandin, Gilbertin dhe Rudinën po ndajme me ju disa çaste të bukura nga ky udhëtim për të cilin janë kujdesur me aq pasion dy fotografët e Grupit të IT Emila dhe Andoni.









AKTIVITETET SOCIAL - KULTURORE PËR ANËTARËT E SEKSIONIT 2 DHE 3.

Këtë herë sindikata ka organizuar për dy seksione njëkohësisht, shitjen, marketingun dhe kujdesin ndaj klientit, një udhëtim me destinacion fshatin turistik Dardhë. Pjesëmarrja e lartë dhe aventurat e këtij udhëtimi e kanë bërë këtë udhëtim më të paharrueshëm për të gjithë pjesëmarrësit. Ngjitja për në fshatin Dardhë ishte e vështirë, por akoma më të vështirë e ka bërë bora zbritjen e grupit, ku mjetet e transportit u bllokuan nga bora e dendur, që nisi papritur. Grupi i anëtarëve të Sindikatës pasi shijuan ushqimet tradicionale të fshatit Dardhë, duke i ardhur njëri-tjetrit në ndihmë kanë filluar zbritjen e malit në këmbë pasi ishte e pa mundur për mjetet e transportit të ecnin në rrugën e bllokuar. Të qeshurat, aventurat, fotografitë, lodhja, rrëshkitja në borë, por mbi të gjitha shpirti i punës në grup, një nga parimet kryesore të sindikatës, ka bërë të mundur që 4 km rrugë në këmbë të kalohen me qetësi edhe se rruga ishte malore e shumë e lodhshme për një pjesë të grupit. Mbrëmja është mbyllur me darkën e organizuar në Korçë për të gjithë anëtarët pjesëmarrës, ku lodhja e fshatit Dardhë ia la vendin, këngëve dhe valleve. Të nesërmen të gjithë pjesëmarrësit patën mundësi të vizitonin, fshatin Tushemisht në Pogradec, ku u ndalën në Drilon edhe në lokalet përrreth për të shijuar ushqimet tradicionale të kësaj zone. Sindikata e ka konsideruar shumë të rëndësishme organizimin e aktiviteteve argëtuese në grup për të realizuar bashkëpunimin më të frtytshëm të anëtarësisë, njohjen më nga afër të tyre, shpirtin e kolektivitetit, por pse jo edhe kalitjen e tyre. Duke falenderuar edhe njëherë të gjithë pjesëmarrësit që u bënë pjesë e këtij udhëtimi po ndajmë me ju fotot gjatë aktivitetit.







